



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 14 prill 2015
Nr. ref.:RK 787/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI159/14

Parashtrues

Elife Murseli

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të
Kosovës, Ac. nr. 1235/2014, të 5 majit 2014**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga znj. Elife Murseli (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës) nga fshati Doganaj, Komuna e Kaçanikut, e cila përfaqësohet nga avokati z. Rifat Abdullahi nga Ferizaj.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 1235/2014, të 5 majit 2014, i cili i ishte dorëzuar asaj më 4 gusht 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 1235/2014 të 5 majit 2014, me të cilin sipas pretendimeve të parashtrueses së kërkesës, janë shkelur nenet 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) dhe 49 (E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 47.1 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 24 tetor 2014, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 6 nëntor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI159/14, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI159/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 10 nëntor 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesen dhe Gjykatën e Apelit të Kosovës për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 11 shkurt 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 16 dhjetor 2008, me Aktvendimin e kryetarit të Komunës së Kaçanikut 01 nr. 8467/08 ishte urdhëruar që nga 15 dhjetori 2008 parashtrueses së kërkesës t'i ndërpritej marrëdhënia e punës në vendin e punës drejtor në Qendrën e Edukimit dhe Arsimit Parashkollor "Agimi" në Kaçanik.
10. Aktvendimi i kryetarit të Komunës së Kaçanikut 01 nr. 8467/08, i 16 dhjetorit 2008, u vërtetua me Vendimin e Komisionit të ankesave në Komunën e Kaçanikut, 01 nr. 8550/08, të 5 shkurtit 2009.

11. Më 6 shkurt 2009, parashtruesja e kërkesës ushtroi ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPMK) kundër Aktvendimit të kryetarit të Komunës së Kaçanikut 01 nr. 8467/08, të 16 dhjetorit 2008 dhe Vendimit të Komisionit të ankesave në Komunën e Kaçanikut, 01 nr. 8550/08, të 5 shkurtit 2009.
12. Më 21 prill 2009, me Vendimin e KPMK-së nr. 794/09 u aprovua ankesa e parashtrueses së kërkesës dhe u prish Aktvendimi 01 nr. 8467/08, i 16 dhjetorit 2008, dhe Vendimi i Komisionit të ankesave në Komunën e Kaçanikut, 01 nr. 8550/08, i 5 shkurtit 2009.
13. Me Vendimin e KPMK-së nr. 794/09, të 21 prillit 2009, në paragrafin II të dispozitivit Komunës së Kaçanikut i urdhërohet si në vijim: *“Obligohet Drejtori i Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Shefi për Administratë dhe Personel në Komunën e Kaçanikut, që në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi ta kthejë ankuesen në vendin e punës Drejtor/e në Qendrën e Edukimit dhe Arsimit Parashkollor "Agimi" në Kaçanik dhe të ja bëjë kompensimin e të ardhurave personale në mënyrë retroaktive nga dt 15.12.2008 deri sa nga autoriteti punëdhënës të bëhet përsëritja e konkursit dhe tërë procedura intervistuese dhe zgjedhja e kandidatit/ës në bazë të meritës sipas vendimit të KPMK-së të dt. 15.04.2009 nr. 782/09”*.
14. Më 21 shtator 2010, parashtruesja e kërkesës paraqiti propozim në Gjykatën Komunale në Kaçanik për lejimin e përmbarimit të Vendimit të KPMK-së nr. 794/09, të 21 prillit 2009.
15. Më 17 janar 2011, me Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Kaçanik E. nr. 390/2010, u refuzua propozimi për lejimin e përmbarimit të Vendimit të KPMK-së, si i palejueshëm.
16. Më 28 qershor 2011, me Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 89/2011, u vërtetua Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Kaçanik E. nr. 390/2010.
17. Kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Kaçanik, E. nr. 390/2010, të 17 janarit 2011 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 89/2011, të 28 qershorit 2011, Prokurori i Shtetit të Kosovës ka paraqitur me kohë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të prishen të dy aktvendimet e lartpërmendura dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë për rivendosje.
18. Më 16 janar 2013, me procesverbalin për pranimin e detyrës nr. 19/2013, Komuna e Kaçanikut përmbaroi vendimin e KPMK-së nr. 794/09 dhe ktheu parashtruesen e kërkesës në vendin e punës drejtor në Qendrën për Edukim dhe Arsim Parashkollor "Agimi" në Kaçanik.
19. Më 3 qershor 2013, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktvendimin MLC. nr. 2/2012 pranoi si të bazuar kërkesën e Prokurorit të Shtetit të Kosovës, dhe prishi Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 89/2011, të 28 qershorit 2011 dhe Aktvendimin e Gjykatës Komunale të Kaçanikut, E. nr.

390/2010, të 17 janarit 2011, dhe lëndën ia ktheu gjykatës së shkallës së parë për rivendosje.

20. Më 4 mars 2014, Gjykata Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik, Aktvendimi E. nr. 269/13 vendosi si në vijim:

I. APROVOHET, pjesërishtë si i bazuar Propzimi për përmbarim i Kreditorës Elife Murseli, nga fshati Doganaj Komuna e Kaçanikut dhe DETYROHET, debitori Komuna e Kaçanikut që kreditorës të ia paguaj shumën prej 6.522.35 €, këtë shumë me kamat si për mjetet e deponuara në bankë pa destinacion të caktuar më shumë se një vit duke filluar prej datës 01.01.2009 e deri më 16.01.2013, në emër të pagave të pa paguar...

II. REFUZHET, si e pa bazuar shuma prej 9.351.30, sepse këtë shumë kreditorja e ka marrë, po ashtu refuzohet edhe kërkesa për kthimin në vendin e punës ku ka punuar më parë SI E PA BAZUAR

III. REFUZHET si i pa bazuar kundërshtimi i debitorit Komuna e Kaçanikut-Drejtoria për Arsim dhe Kulturë, i ushtruar më dt.01.06.2009, kundër aktvendimit mbi lejimin e ekzekutimit E.nr.229/09, prej datës 15.05.2009.

IV. DETYROHET, debitori që kreditorit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës përmbarimore në shumë prej 927 €, e cila pagesë do të bëhet në llogarin e të autorizuarit të Kreditorit me nr 1170172318000108 , ne Pro Credit bank në Ferizaj, te gjitha këto pagesa do të bëhen në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi”.

21. Kundër këtij Aktvendimi, brenda afatit ligjor, kreditorja ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar.
22. Më 5 maj 2014, Gjykata e Apelit të Kosovës, me Aktvendimin Ac. nr. 1235/2014, refuzoi ankesën e parashtrueses së kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj - Dega në Kaçanik, E. nr. 269/2013, të 4 marsit 2014, me arsyetim:

“Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë, kur pas nxjerrjes së provës me Ekspertizë financiare të datës 26.12.2013, me të cilën janë vërtetuar shumat që i përkasin kreditorës Elife, e ka miratuar pjesërishtë si të bazuar propozimin e saj për përmbarim, dhe ka detyruar debitorin Komuna e Kaçanikut, që t'ia paguaj shumën prej 6.522,35 €, në emër të pagave të pa paguara, me kamatë si për mjetet e deponuara në banke pa destinim të caktuar më shumë se një vit duke filluar prej datës 1.1.2009 e deri me 16.1.2013, e në këtë shumë ta paguaj edhe kontributin për Trustin Pensional, duke e refuzuar si të pabazuar për shumën prej 9.351,30 € (që i është zbritur nga shuma e neto kompensimit të tërësishëm në shumë prej 15.873,65 € për kohën kontestuese 1.1.2009-16.1.2013), me konstatimin dhe arsyetimin e drejtë se këtë shumë kreditorja e ka realizuar te debitorja, si delegate e Asamblesë Komunale (gjatë kohës sa ka qenë jashtë

marrëdhënies së punës), bashkë me kërkesën e saj për kthim në vendin e punës ku ka punuar më parë, pasi që debitorja është kthyer në punë nga vet debitorja, prandaj kjo kërkesë e saj tani është jo lëndore, prandaj të gjitha pretendimet ankimore të kreditores rezultojnë si të pa qëndrueshme dhe të pa argumentuara me asgjë”.

23. Parashtruesja e kërkesës si dëshmi, se procedura e emërimit të drejtorit në Qendrën për Edukim dhe Arsim Parashkollor "Agimi" - Kaçanik nuk është përmbyllur, i dorëzon dy vendimet e KPMK-së nr. 02/370/2013, të 20 nëntorit 2013 dhe nr. A/02/46/2014, të 17 prillit 2014.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesja e kërkesës pretendon se *“qëndrimi i Gjykatave të instancave gjyqsore të gjykatave të rregullta se sipas njoftimit nga Debitori, kreditorja është kthyer në punë me dt.16.01.2013 dhe se kërkesa për kthim në punë është jo lëndore, nuk ka mbështetje në ligj dhe në esencë është qëndrim i gabuar, sepse kthimi në punë sipas vendimit të KPMK dot zgjaste deri sa të merret vendim i formës së prere lidhur me zgjedhjen e kandidatit për Drejtor të QEAP "Agimi" në Kacanik e jo siq është vepru ndaj kreditores kur ende pa perfunduar zgjedhja e Drejtorit, kreditorja me forcë largohet nga vendi i punës. Vlene të theksohet se me vendimin e kryetarit të Komunes as që permendet kohezgjatja e vlefshmerise se atij vendimi”.*
25. Parashtruesja e kërkesës më tej pretendon se *“sa i përket refuzimit të kërkesës së kreditores lidhur me pagesën e Shumes prej 9.351,30 euro, parashtruesit e kesaj kërkesë konsiderojnë se me vendimet gjyqsore gabimisht është aplikuar në rastin konkret nën 65 i ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, kete sepse, kreditorja në menyre të paligjshme është larguar nga detyra e Drejtorit të QEAP, pastaj si person i papunë ka patur të drejtë të zgjidhet si delegate në Kuvendin Komunal. Prandaj edhe sa i përket refuzimit të pagesës së kesaj shume, Gjykatat e permendur a kanë shkelur ligjin lidhur me pagesën e shumave që kanë të bëjnë me pagat e papaguara, të drejta të cilat iu janë shkelur me vendimet e kundërshtuara të Gjykatave të rregullta “.*
26. Parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese si në vijim:

I. TË SHPALLË, kërkesën të pranueshme.

II. TË KONSTATOJË që ka patur shkelje të nenit 31 (e drejta për gjykim të drejtë dhe të papanshem) nën 49 (e drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit dhe të drjtat në kompenzimin e pagave të papaguara) të Kushtetutes së Republikës së Kosovës.

III. TË ANULOJË Aktvendimin i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr. 1235/14 dt. 05.05.2014 dhe Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj - Dega në Kacanik në pjesën nën II. të diapozitivit E.nr.269/13 dt. 04.03.2014.

IV. TË DETYROJË Komunën e Kacanikut që kreditorin Elife Murseli ta kthejë në vendin e punës së Drejtores së QEAP "Agimi" në Kacanik që të

ushtrij detyren e Drejtoreshes deri sa te shpallet konkursi per ate vend pune dhe zbatohet procedura deri ne vendim te forms se prere per zgjedhjen e kandidatit per Drejtor te QEAP dhe kreditores ti paguaj ne menyre retroaktive pagat e papaguara prej 01.10.2013 e deri sa ne procedure te ligjshme dhe perfundimtare te zgjedhet Drejtori I QEAP "Agimi" ne Kacanik, kete sipas vendimit te KPMK nr. 794/2009 dt. 21.04.2009.

- V. *TË DETYROJË Komunën e Kacanikut qe kreditores te ia paguaj Shumen prej 9.351,30 euro ne emer te shumes nga pagat e papaguara prej 01.01.2009 e deri me dt. 16.01.2013“.*

Pranueshmëria e kërkesës

27. Gjkata së pari shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

28. Në këtë drejtim, Gjkata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

29. Gjkata i referohet edhe nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj “.

30. Përveç kësaj, Gjkata i referohet rregullit 36 (2) b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

„(2) Gjkata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

...

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese“.

31. Duke shqyrtuar pretendimet e parashtrueses lidhur me kërkesën për kthim në vendin e punës, Gjkata vëren se Vendimi i KPMK-së numër 794/09, i 21 prillit 2009, e obligon Komunën e Kaçanikut që *"ta kthejë ankuesen në vendin e punës Drejtor/e në Qendrën e Edukimit dhe Arsimit Parashkollor "Agimi" në Kaçanik, dhe të ja bëjë kompensimin e të ardhurave personale në mënyrë retroaktive nga dt. 15.12. 2008 deri sa nga autoriteti punëdhënës të bëhet përsëritja e konkursit".*

32. Komuna e Kaçanikut me procesverbalin e pranimit të detyrës nr. 19/2013, të 16 janarit 2013, ka vepruar në përputhje me Vendimin e KPMK-së nr. 794/09,

duke e kthyer parashtruesen e kërkesës në vendin e punës drejtor në Qendrën për Edukim dhe Arsim Parashkollor "Agimi" në Kaçanik.

33. Kjo gjendje faktike është konstatuar me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj - Dega në Kaçanik, E. nr. 269/13, të 4 marsit 2014.
34. Duke shqyrtuar pretendimet e parashtrueses për refuzimin e kërkesës pronësore lidhur me pagesën në shumë prej €9.351,30 dhe pretendimit se në rastin në fjalë, në vendimet gjyqësore është aplikuar gabimisht neni 65 i Ligjit për vetëqeverisje lokale, Gjykata Kushtetuese thekson se ajo nuk është Gjykatë e Apelit, kur shqyrtohen vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta.
35. Roli i gjykatave të rregullta është që të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, *García Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
36. Aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac. nr. 1235/2014, i 5 majit 2014 dhe Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Dega në Kaçanik, E. nr. 269/13, i 4 marsit 2014, në arsyetimet e tyre të hollësishme japin përgjigje në pretendimet e parashtrueses përkitazi me kërkesën për kthim në vendin e punës dhe kërkesën pronësore në shumë prej €9.351,30, si dhe arsyet për aplikimin e rregullave përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale, të cilat parashtruesja e kërkesës i përsërit edhe në Gjykatën Kushtetuese.
37. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës nuk i konteston vendimet e KPMK-së nr. 02/370/2013, të 20 nëntorit 2013 dhe nr. A/02/46/2014, të 17 prillit 2014, por këto dy vendime të KPMK-së ajo i ka bashkëngjitur si dëshmi se procedura e emërimit të drejtorit në Qendrën për Edukim dhe Arsim Parashkollor "Agimi" në Kaçanik ende nuk ka përfunduar.
38. Pasi që kushtetutshmëria e këtyre vendimeve nuk është kontestuar nga parashtruesja e kërkesës, Gjykata konsideron se vlerësimi i kushtetutshmërisë së këtyre dy vendimeve të KPMK-së nuk është objekt i çështjes në Gjykatën Kushtetuese dhe ajo nuk do ta bëjë vlerësimin e kushtetutshmërisë së tyre.
39. Gjykata Kushtetuese thekson se parashtruesja e kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë provë *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave të saj kushtetuese (Shih, *Vanek kundër Republikës Sllovaqe*, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99, i 31 majit 2005).
40. Në këtë rast, parashtrueses së kërkesës i janë dhënë mundësitë për ta paraqitur rastin e saj dhe për ta kontestuar interpretimin e ligjit që ajo konsideron se është i pasaktë, në KPMK, Gjykatën Themelore në Ferizaj - Dega në Kaçanik, Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë dhe në Gjykatën Supreme të Kosovës.
41. Pas shqyrtimit të procedurave në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka gjetur se procedurat përkatëse kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

42. Përfundimisht, në këtë kërkesë nuk janë plotësuar kushtet për pranueshmëri. Parashtruesja e kërkesës nuk ka treguar dhe nuk ka mbështetur me prova se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese të pretenduara.
43. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (2) b) të Rregullores.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 14 prill 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Ivan Čukalović



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani